



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:240200
Datë: 27.12.2024
Numri i dokumentit: 06662637

C.nr.2598/2024

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Blerim Istrefi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Z.M. nga Mitrovica, të cilin e përfaqëson Shqipe Mehmeti-Jusufi av. me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna e Zubin Potokut-DKA, baza e kontestit: Kompensim i shujtave ditore, vlera e kontestit:302.00 euro, jashtë seance gjyqësore me datë 27.12.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M
për shkak të pa dëgjueshmërisë – mosbindjes

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Z.M. nga Mitrovica, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Zubin Potokut, që paditëses, në emër të kompensimit të shujtave për ditët e pranisë në punë për periudhën kohore 24.09.2020 e deri me 07.06.2021 apo për 151 ditë pune “nga 2 euro dita”, t’ia paguaj shumën e përgjithshme të detyrimit prej 302.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data 15.07.2024, datë e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën përfundimtare të detyrimit, të gjitha këto (borxhin kryesor dhe kamatën) në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. OBLIGOHET e paditura Komuna e Mitrovicës Jugore qe paditëses në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumën prej 98.00 euro, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit me padi të datës 15.07.2024, ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Zubin Potokut që paditëses, në emër të kompensimit të shujtave për ditët e pranisë në punë për periudhën kohore 24.09.2020 e deri me 07.06.2021 apo për 151 ditë pune “nga 2 euro dita”, t’ia paguaj shumën e përgjithshme të detyrimit prej 302.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data 15.70.2024, datë e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën përfundimtare të detyrimit, të gjitha këto (borxhin kryesor dhe kamatën) në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi me datë 24.10.2024, të cilin e paditura e ka pranuar me dt. 30.10.2024, (e cila është konfirmuar përmes fletë kthesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës).

Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjegjës në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes - pa dëgjueshmërisë.

E paditura, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150 paragrafi 1 pikat a), b) dhe (c) të LPK-së, nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadiës del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Themelësia e kërkesëpadiës del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, dhe atë: Nga vërtetim me nr prot.12/1/2024 i dt.14.06.2024 me të cilin vërtetohet fakti se paditësja është e punësuar tek e paditura si dhe për periudhën kohore 24.09.2020 e deri me 07.06.2021 ka gjithsej 151 dit pune.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën nr.265/2020 të datës 01.12.2020, ka marr datën e ushtrimit të padisë (data 15.07.2024), e ku lartësia e kamatës vjetore është e definuar 8% deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, lartësia e shpenzimeve i referohet 78 € për përpilim padisë si dhe 20 € në emër të taksës gjyqësore për padi.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i'u referuar dispozitës së nenit 150 par.1 pika a, b, dhe c të LPK-së, e në lidhje më dispozitat e nenit 245 par.1 dhe 2, neni 249 par.1 dhe 2 të LMD-së.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
C.nr.2598/2024 dt.27.12.2024

Gjyqtari
Blerim Istrefi

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjyskate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë